



SHOQERIA "LIRENG AUDITING" SH.P.K

Adresa: Rruga "Dibres" Pall.324/1 Tirane

Email: lireng.auditing@gmail.com

Tel/Fax: +355 42 450 952

Mob: 0672079155

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR PER AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TE AKTIVITETIT TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR PER PERIUDHEN 01.01.2014-31.12.2014

KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

TIRANE

TE NDERUAR ZOTERINJ!

Ne ekzekutimin e misionit qe na eshte besuar, kemi audituar Pasqyrat Financiare te "Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar "(OJF), te cilat perfshijne pasqyrimin financiar per periudhen 1 Janar - 31 Dhjetor 2014 te sintetizuar ne Bilancin Kontabel te dates 31 Dhjetor 2014, pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyren e flukseve te parase, pasqyren e ndryshimeve ne kapital si dhe nje permbledhje te metodave kontabel me te rendesishme dhe shenime te tjera anekse qe shoqerojne keto pasqyra.

Drejtimi i entitetit eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e pershtatshme e te singerte te ketyre Pasqyrave Financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Kjo pergjegjesi perfshin;hartimin, venien ne zbatim dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pergatitjen dhe paraqitjen e singerte te ketyre pasqyrave financiare pa anomali materiale te shkaktuara nga mashtrimi ose gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtatshme kontabel, si dhe kryerjen e çmuarjeve kontabel qe jane te arsyeshme per rrethanat e dhena.

Pergjegjesia e shoqerise tone audituese eshte qe te shprehim nje opinion per keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin e kryer. Auditimi i kryer nga ana e jone u be ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te zbatojme kerkesat e etikes dhe te planifikojme e te kryejme auditimin me qellimin, per te marre siguri te arsyeshme nese Pasqyrat Financiare jane pa anomali materiale.

Auditimi perfshiu;

- kryerjen e procedurave per te mare evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare.Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit, duke perfshire vleresimin e rreziqeve per anomali materiale ne pasqyrat financiare, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit.

- Ne berjen e ketyre vleresimeve te rrezikut, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem perkates te entitetit ne pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare ne menyre qe te hartoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat perkatese te entitetit, por jo per qellimin e shprehjes se opinionit per efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit.
- Auditimi gjithashtu perfshin vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe llogjiken e çmuarjeve kontabel te bere nga drejtimi me vecorite specifike te saj, si dhe per vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.
- Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.

Sipas opinionit tone, Pasqyrat Financiare te Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te gjendjes financiare per periudhen ushtrimore Janar - Dhjetor 2014, dhe performancen e saj financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Audituesi

“LIRENG Auditing” Sh.p.ë

Neshat MAZE (Ekspert Kontabel) Regjistruar



Tirane, Shkurt 2015